

G2 Media sh.p.k

NIPT: K71616017T

PASQYRAT FINANCIARE

**TË PËRGATITURA NË PËRPUTHJE ME
STANDARDET KOMBËTARE TË KONTABILITETIT
MË DHE PËR VITIN E MBYLLUR MË 31 DHJETOR 2020**

Përmbajtja

RAPORTI I AUDITUESIT TË PAVARUR.....	i-iii
PASQYRA E POZICIONIT FINANCIAR.....	1
PASQYRA E PERFORMANCËS	2
PASQYRA E FLUKSEVE MONETARE	3
PASQYRA E NDRYSHIMEVE TË KAPITALIT	4
SHËNIME MBI PASQYRAT FINANCIARE	5
1 Informacion i Përgjithshëm	5
2 Bazat e përgatitjes dhe Deklarata e Përputhshmërisë.....	6
3 Politikat kryesore kontabël.....	7
4 Mjete monetare dhe ekuivalente me to.....	14
5 Llogari të arkëtueshme	14
6 Të tjera të arkëtueshme.....	14
7 Parapagimet dhe shpenzimet e shtyra	15
8 Aktive afatgjata materiale	15
9 Aktive afatgjata jomateriale	16
10 Huatë bankare.....	16
11 Llogari te Pagueshme	17
12 Detyrime ndaj shtetit	17
13 Te tjera detyrime afatshkurtra	18
14 Kapitali i pronarëve	18
15 Shitjet neto.....	18
16 Shpenzime te tjera nga veprimtaria e shfrytezimit.....	19
17 Kosto e Punës	19
18 Amortizimi dhe zhvleresimet	20
19 Të ardhura dhe shpenzime nga interesi	20
20 Fitim / humbjet nga kursi i kembimit.....	20
21 Te ardhura dhe shpenzime të tjera financiare.....	21
22 Shpenzimet e tatimit mbi fitimin.....	21
23 Ngjarjet pas bilancit.....	21



Raporti i Audituesit të Pavarur

Për pronarët e Shoqërise “G2 Media” Sh.p.k,

Opinion

Ne kemi audituar pasqyrat financiare të Shoqërisë “G2 Media” sh.p.k (në vijim referuar si “Shoqëria”), të cilat përfshijnë pasqyrën e pozicionit financiar më datën 31 dhjetor 2020, dhe pasqyrën e performancës, pasqyrën e ndryshimeve në kapital dhe pasqyrën e flukseve monetare për vitin që mbyllet më këtë datë, si edhe shënimet shpjeguese për pasqyrat financiare, përfshirë një përmbledhje të politikave kontabël më të rëndësishme.

Sipas opinionit tonë, pasqyrat financiare bashkëlidhur, paraqesin drejt, në të gjitha aspektet materiale, pozicionin financiar të Shoqërisë më 31 dhjetor 2020, dhe performancën financiare dhe flukset e mjeteve monetare për vitin e mbyllur më këtë datë, në përputhje me Ligjin 25/2018 datë 10.05.2018 “Për Kontabilitetin dhe pasqyrat financiare” dhe Standartet Kombëtare të Kontabilitetit.

Baza për Opinionin

Ne e kryem auditimin tonë në përputhje me Standardet Ndërkombëtare të Auditimit (SNA-të). Përgjegjësitë tona sipas këtyre standardeve janë përshkruar në mënyrë më të detajuar në seksionin e raportit ku jepen *Përgjegjësitë e Audituesit për Auditimin e Pasqyrave Financiare*. Ne jemi të pavarur nga Shoqëria në përputhje me Kodin e Etikës për Profesionistët Kontabël të Bordit të Standardeve Ndërkombëtare të Etikës për Profesionistët Kontabël (Kodi i BSNEPK) së bashku me kërkesat etike që janë të zbatueshme për auditimin e pasqyrave financiare në Shqipëri, dhe kemi përmbushur përgjegjësitë e tjera etike në përputhje me këto kërkesa dhe me Kodin e BSNEPK. Ne besojmë se evidenca e auditimit që kemi siguruar është e mjaftueshme dhe e përshtatshme për të dhënë një bazë për opinionin tonë.



Përgjegjësitë e Drejtimit dhe të Personave të Ngarkuar me Qeverisjen në lidhje me Pasqyrat Financiare

Drejtimi është përgjegjës për përgatitjen dhe paraqitjen e drejtë të pasqyrave financiare në përputhje me Standartet Kombetare të Kontabilitetit, dhe për ato kontrole të brendshme që drejtimi i gjykon të nevojshme për të bërë të mundur përgatitjen e pasqyrave financiare që nuk përmbajnë anomali materiale, qoftë për shkak të mashtrimit apo gabimit.

Në përgatitjen e pasqyrave financiare, drejtimi është përgjegjës për të vlerësuar aftësinë e Shoqërisë për të vazhduar në vijimësi, duke dhënë informacion, nëse është e zbatueshme, për çështjet që kanë të bëjnë me vijimësinë dhe duke përdorur parimin kontabël të vijimësisë përveç se në rastin kur drejtimi synon ta likujdojë Shoqërinë ose të ndërpresë aktivitetet, ose nëse nuk ka alternativë tjetër reale përveç sa më sipër.

Personat e ngarkuar me qeverisjen janë përgjegjës për mbikëqyrjen e procesit të raportimit financiar të Shoqërisë.

Përgjegjësitë e Audituesit për Auditimin e Pasqyrave Financiare

Objektivat tona janë që të arrijmë një siguri të arësyeshme lidhur me faktin nëse pasqyrat financiare në tërësi nuk kanë anomali materiale, për shkak të mashtrimit apo gabimit, dhe të lëshojmë një raport auditimi që përfshin opinionin tonë. Siguria e arësyeshme është një siguri e nivelit të lartë, por nuk është një garanci që një auditim i kryer sipas SNA-ve do të identifikojë gjithmonë një anomali materiale kur ajo ekziston.

Anomalitë mund të vijnë si rezultat i gabimit ose i mashtrimit dhe konsiderohen materiale nëse, individualisht ose të marra së bashku, pritet që në mënyrë të arësyeshme të influencojnë vendimet ekonomike të përdoruesve, të marra bazuar në këto pasqyra financiare.

Si pjesë e auditimit në përputhje me SNA-të, ne ushtrojmë gjykimin profesional dhe ruajmë skepticizmin profesional gjatë gjithë auditimit. Ne gjithashtu:

- identifikojmë dhe vlerësojmë rreziqet e anomalisë materiale, qoftë për shkak të mashtrimit ose gabimit, hartojmë dhe kryejmë procedurat e auditimit në përgjigje të këtyre rreziqeve, dhe marrim evidencë auditimi që është e mjaftueshme dhe e përshtatshme për të siguruar një bazë për opinionin tonë. Rreziku i moszbulimit të një anomalie materiale si rezultat i mashtrimit është më i lartë se rreziku si rezultat i gabimit, sepse mashtrimi mund të përfshijë marrëveshje të fshehta, falsifikime, përjashtime të qëllimshme, informacione të deformuara, anashkalime të kontroleve të brendshme.
- sigurojmë një njohje të kontrollit të brendshëm që ka të bëjë me auditimin, me qëllim që të përcaktojmë procedurat e auditimit që janë të përshtatshme sipas rrethanave, por jo për qëllime të shprehjes së një opinionimi mbi efikasitetin e kontrollit të brendshëm të Shoqërisë.



“FILTO Auditing” sh.p.k.

- vlerësojmë përshtatshmërinë e politikave kontabël të përdorura dhe arsyeshmërinë e çmuarjeve kontabël dhe të shpjegimeve përkatëse të bëra nga drejtimi.
- nxjerrim një konkluzion në lidhje me përshtatshmërinë e përdorimit të bazës kontabël të vijimësisë, dhe bazuar në evidencën e auditimit të marrë, nëse ka një pasiguri materiale në lidhje me ngjarjet ose kushtet, e cila mund të hedhë dyshime të mëdha për aftësinë e Shoqërisë për të vijuar veprimtarinë. Nëse ne arrijmë në përfundimin që ka një pasiguri ne duhet të tërheqim vëmendjen në raportin e audituesit në lidhje me shpjegimet e dhëna në pasqyrat financiare, ose nëse këto shpjegime janë të papërshtatshme, duhet të modifikojmë opinionin tonë. Konkluzionet tona bazohen në evidencën e auditimit të marrë deri në datën e raportit tonë. Megjithatë, ngjarje ose kushte të ardhshme mund të bëjnë që Shoqëria të ndërpresë veprimtarinë.
- vlerësojmë paraqitjen e përgjithshme, strukturën dhe përmbajtjen e pasqyrave financiare, përfshirë informacionet shpjeguese të dhëna, dhe nëse pasqyrat financiare paraqesin transaksionet dhe ngjarjet në to në një mënyrë që arrin paraqitjen e drejtë.

Ne komunikojmë me personat e ngarkuar me qeverisjen, përveç të tjerave, lidhur me qëllimin dhe kohën e auditimit dhe gjetjet e rëndësishme të auditimit, përfshirë ndonjë mangësi të rëndësishme në kontrollin e brendshëm që ne mund të identifikojmë gjatë auditimit.

Tiranë, 25 mars 2021

FILTO Auditing sh.p.k

Tatjana FILTO,

Audituese Ligjore

PASQYRA E POZICIONIT FINANCIAR

<u>AKTIVET</u>	Shënime	31 dhjetor 2020	31 dhjetor 2019
I. Aktivet afatshkurtra			
Mjete monetare dhe ekuivalentë me to	4	657,501	519,944
Llogari të arkëtueshme	5	41,368,379	7,485,015
Të tjera të arkëtueshme	6	95,992	5,794,179
Parapagimet dhe shpenzimet e shtyra	7	54,734,294	50,778,621
Total i Aktiveve Afatshkurtra		96,856,166	64,577,759
II. Aktivet afatgjata			
Aktive afatgjata materiale	8	45,356,335	51,096,608
Aktivet afatgjata jomateriale	9	15,055,694	4,477,522
Totali i Aktiveve Afatgjata		60,412,029	55,574,130
TOTALI I AKTIVEVE		157,268,195	120,151,889
<u>DETYRIMET DHE KAPITALI</u>			
I. Detyrimet afatshkurtra			
Huatë afatshkurtra	10	16,853,190	-
Llogari të Pagueshme	11	41,098,913	20,262,039
Detyrime ndaj shtetit	12	4,323,391	4,293,048
Parapagime të arkëtuara		27,742,716	-
Të tjera detyrime afatshkurtra	13	10,372,483	10,182,304
Totali i Detyrimeve Afatshkurtra		100,390,693	34,737,391
II. Detyrimet afatgjata			
Huatë afatgjata	10	8,593,608	-
Detyrime të tjera afatgjata		98,752,459	97,214,013
Totali i Detyrimeve Afatgjata		107,346,067	97,214,013
Totali i detyrimeve		207,736,760	131,951,404
III. Kapitali			
Kapitali i pronarëve	14	10,000,000	10,000,000
Humbje të mbartura		(21,799,515)	(21,952,535)
(Humbja)/ Fitimi i vitit financiar		(38,669,050)	153,020
Totali i Kapitalit		(50,468,565)	(11,799,515)
TOTALI I DETYRIMEVE DHE KAPITALIT		157,268,195	120,151,889

Pasqyra e Pozicionit Financiar duhet të lexohet së bashku me shënimet në faqet 5 deri në 21 të cilat janë pjesë përbërëse të këtyre pasqyrave.

PASQYRA E PERFORMANCËS

	Shënime	Viti i mbyllur më 31 dhjetor 2020	Viti i mbyllur më 31 dhjetor 2019
Të ardhurat			
Shitjet neto	15	304,390,494	388,229,392
Të ardhura nga prodhimi i aktive afatgjata jomateriale	15	11,249,800	-
Total i të ardhurave		315,640,294	388,229,392
Shpenzimet			
Shpenzime të tjera	16	(177,433,165)	(205,519,320)
Kosto e punës	17	(170,936,813)	(171,915,217)
Amortizimi dhe zhvlerësimet	18	(10,053,256)	(9,403,134)
Totali i shpenzimeve		(358,423,235)	(386,837,671)
(HUMBJA)/ FITMI NGA VEPRIMTARIA KRYESORE		(42,782,941)	1,391,721
Të ardhura dhe shpenzime financiare			
Të ardhura dhe shpenzime nga interesi	19	(202,195)	80
Fitimet/humbjet nga kursi i këmbimit	20	2,808,661	(1,858,207)
Të ardhura dhe shpenzime të tjera financiare	21	1,507,424	619,425
Totali i të ardhura & shpenzime financiare		4,113,890	(1,238,701)
(HUMBJA)/ FITIMI PARA TATIMIT		(38,669,050)	153,020
Shpenzimet e tatimit mbi fitimin	22	-	-
(HUMBJA)/ FITIMI NETO I VITIT		(38,669,050)	153,020

Pasqyra e Performancës duhet të lexohet së bashku me shënimet në faqet 5 deri në 21 të cilat janë pjesë përbërëse të këtyre pasqyrave.

PASQYRA E FLUKSEVE MONETARE

	Viti i mbyllur më 31 dhjetor 2020	Viti i mbyllur më 31 dhjetor 2019
I. Fluksi monetar nga veprimtarite e shrytezimit		
Fitimi para tatimit	(38,669,050)	153,020
<i>Rregullime për:</i>		
Amortizimin	10,053,256	9,403,134
Shpenzimet e interesit	202,395	-
	(28,413,399)	9,556,155
<i>Ndryshimet në kapitalin punues</i>		
Rritje në Llogari të arkëtueshme	(33,883,364)	(7,485,015)
Rënie/ (Rritje) në Të tjera të arkëtueshme	5,698,187	(3,235,555)
(Rritje)/ Rënie në Parapagime dhe Shpenzime të shtyra	(3,955,673)	19,505,263
Rritje/ (Rënie) në Llogari të Pagueshme	20,836,874	(554,867)
Rritje/ (Rënie) në Detyrime ndaj shtetit	30,343	419,986
Rritje/ (Rënie) në Parapagime të arkëtuara	27,742,716	-
Rritje /Rënie në Të tjera detyrime afatshkurtra	190,179	1,173,512
MM neto nga aktiviteti i shfrytezimit	(11,754,137)	19,379,479
Interes i paguar	(202,395)	-
MM neto nga aktiviteti i shfrytezimit	(11,956,532)	29,202,804
II. Fluksi monetar nga veprimtarite investuese		
Blerje e aktiveve afatgjata jo materiale	(11,249,800)	(1,291,637)
Blerje e aktiveve afatgjata materiale	(3,641,355)	(52,988,383)
MM neto, perdorur ne aktivitetet investuese	(14,891,155)	(54,280,020)
III. Fluksi monetar nga veprimtarite financiare		
Hyrje nga huamarrje afatgjata	31,130,512	34,706,363
Ripagim i huave afatgjata	(4,145,268)	-
MM neto gjeneruar në aktivitetet financiare	26,985,244	34,706,363
Rritja /renia neto e mjeteve monetare	137,556	(194,177)
Mjetet monetare ne fillim te periudhes kontabel	519,944	714,122
Mjetet monetare ne fund te periudhes kontabel	657,501	519,944

Pasqyra e Flukseve Monetare duhet të lexohet së bashku me shënimet në faqet 5 deri në 21 të cilat janë pjesë përbërëse të këtyre pasqyrave.

PASQYRA E NDRYSHIMEVE TË KAPITALIT

	Kapitali aksionar	Humbja e mbartur	Totali
Pozicioni me 1 janar 2019	10,000,000	(21,952,535)	(21,952,535)
Fitimi (humbja) e vitit	-	153,020	153,020
Pozicioni më 31 dhjetor 2019	10,000,000	(21,799,515)	(21,799,515)
Pozicioni më 1 janar 2020	10,000,000	(21,799,515)	(11,799,515)
Fitimi (humbja) e vitit	-	(38,669,050)	(38,669,050)
Pozicioni më 31 dhjetor 2020	10,000,000	(60,468,565)	(50,468,565)

Pasqyra e Ndryshimeve të Kapitalit duhet të lexohen së bashku me shënimet në faqet 5 deri në 21 të cilat janë pjesë përbërëse të këtyre pasqyrave.

Këto pasqyra financiare dhe shënimet shpjeguese janë miratuar nga drejtimi më datë 17 mars 2021 dhe janë nënshkruar në emër të tij nga:

Z. Andri KASNECI
Administrator

Z. Edon SHKEMBI
Përgjegjës për Financën dhe Kontabilitetin

SHËNIME MBI PASQYRAT FINANCIARE

1 Informacion i Përgjithshëm

Organizimi

Shoqëria “G2 Media” sh.p.k është krijuar si shoqëri me përgjegjësi të kufizuar me vendim të ortakeve të datës 02.12.2004 dhe është regjistruar në Qendren Kombëtare të Regjistrimit më datë 02.12.2004. Shoqëria më 2/2/2018 ka ndryshuar emrin e saj nga “ALBANIA BYATY” shpk në “G2 MEDIA” shpk. Shoqëria është regjistruar pranë organeve tatimore me numrin unik të identifikimit K71616017T.

Veprimtaria e saj rregullohet sipas dispozitave perkatëse të Ligjit 9901 datë 14.04.2008, “Për tregtarët dhe shoqëritë tregtare” si dhe nga statuti dhe legjislacioni shqiptar në fuqi.

Objekti

Shoqëria “G2 Media” sh.p.k ka si objekt veprimtarinë televizive, prodhim, transmetim dhe ritransmetim të programeve, informacioneve të çdo lloji të zerit, figures, sinjaleve të koduara, etj, të destinuara për publikun nëpërmjet valeve elektromagnetike, kablllove, perseritesve, sateliteve, apo me çdo mjet tjetër.

Në vitin 2020 kjo shoqëri ka kryer aktivitetin në media televizive.

Numri mesatar i punonjësve:

Për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2020 numri mesatar i punonjësve ka qenë 102.

Palët e lidhura:

Palë e lidhur është Gener 2 Sh.p.k.. Transaksionet janë fatura të leshuara dhe financim për shpenzime.

Selia qendrore dhe Administrimi

Shoqëria zhvillon aktivitetin e saj në ambiente qera me adresë Njesinë Bashkiake Nr.2, Rruga Papa Gjon Pali II, Ndertesa Nr.12, ABA Business Center, Kati 10-te.

Shoqëria drejtohet nga Administratori z.Andri Kasneci, të cilit i perkasin të gjitha kompetencat për drejtimin ekzekutiv të përgjithshëm.

2 Bazat e përgatitjes dhe Deklarata e Përputhshmërisë

2.1 Deklarata e Përputhshmërisë

Pasqyrat financiare janë përgatitur në përputhje me kërkesat e raportimit financiar dhe legjislacionit në Shqipëri. Kuadri kontabël i aplikuar është i bazuar në politikat kontabël të listuara në shënimin 3, të cilat janë të bazuara në kërkesat për raportim sipas Standarteve Kombëtare të Kontabilitetit (“SKK”), të publikuara nga Këshilli Kombëtar i Kontabilitetit (“KKK”). Më poshtë paraqiten politikat kontabël kryesore të aplikuar në përgatitjen e këtyre pasqyrave financiare.

Pasqyrat Financiare më dhe për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2020 janë paraqitur në formatin e paraqitur në Standartet Kombëtare të Kontabilitetit në fuqi (SKK 2).

2.2 Bazat e përgatitjes

Pasqyrat financiare janë përgatitur bazuar në parimin e të drejtave dhe detyrimeve të konstatuara.

Këto pasqyra financiare janë përgatitur në bazë të kostos historike.

2.3 Monedha funksionale dhe e prezantimit

Këto pasqyra financiare janë prezantuar në monedhën shqiptare “Lekë”, e cila është monedha funksionale. Përveç rasteve kur është shënuar ndryshe, informacioni financiar është paraqitur në lekë.

2.4 Parimi i Vijimësisë

Pasqyrat financiare janë përgatitur bazuar në parimin e vijimësisë.

Drejtimi i Shoqërisë ka arritur në përfundim se nuk ka pasiguri të qenësishme në aftësinë e Shoqërisë për të vazhduar veprimtarinë e saj në vijimësi, për të ardhmen e parashikueshme, prej të paktën 12 muajsh nga data e aprovimit të këtyre pasqyrave financiare. Si rrjedhojë, Drejtimi gjykon se parimi i vijimësisë është bazë e përshtatshme në përgatitjen e këtyre pasqyrave.

3 Politikat kryesore kontabël

3.1 Instrumentat financiarë

Aktivitet dhe detyrimet financiare njihen kur Shoqëria bëhet palë e dispozitave kontraktuale të instrumentit financiar.

Aktivitet financiarë çregjistrohen kur skadojnë të drejtat kontraktuale të flukseve të mjeteve monetare nga aktivi financiar, ose kur aktivitet financiarë transferohen dhe në thelb të gjitha rreziqet dhe përfitimet transferohen.

Një detyrim financiar çregjistrohet kur shuhet, shkarkohet, anulohet ose skadon.

Të gjitha aktivitet financiarë fillimisht maten me vlerën e drejtë të rregulluar për kostot e transaksionit (aty ku është e aplikueshme) përveç rasteve kur marrëveshja përbën në thelb, një transaksion financiar. Një transaksion financiar mund të jetë, për shembull, kur shiten mallra apo shërbime dhe kur pagesa shtyhet përtej afateve normale të tregtisë ose kur ajo është financuar me një normë interesi që nuk është një normë tregu. Nëse marrëveshja përbën një transaksion financiar, njësia duhet të masë aktivin financiar ose detyrimin financiar me vlerën aktuale të pagesave të ardhshme të skontuara me normën e interesit të tregut për një instrument të ngjashëm borxhi.

Shoqëria ka vetem instrumenta financiarë jo derivative, përfshirë llogari të arkëtueshme dhe të tjera të arkëtueshme, mjete monetare dhe ekuivalentë të tyre, huamarrje, llogari të pagueshme dhe të tjera të pagueshme.

Mjetet Monetare

Mjetet monetare dhe ekuivalentët e tyre përfshinë paratë në arkë, llogari rrjedhëse në banka, të tjera investime afatshkurtra shumë likuide me afat maturimi deri në tre muaj.

Llogari të arkëtueshme dhe të tjera të arkëtueshme

Llogaritë e arkëtueshme dhe të tjera të arkëtueshme afatshkurtra janë paraqitur në Pasqyrën e Pozicionit Financiar me kosto të amortizuar, pra me vlerën e kostos së tyre minus zhvlerësimet e krijuara për rënie në vlerë. Zhvlerësimet e lejuara mund të llogariten, për shumat e vlerësuarat si të parikuperueshme, në Pasqyrën e Performancës kur ekziston një evidencë objektive që këto kërkesa janë zhvlerësuar më parë.

Llogari të pagueshme dhe të tjera të pagueshme

Llogari të pagueshme dhe të tjera të pagueshme njihen me vlerën e drejtë të tyre që është shuma e pritshme e pagesa të ardhme që do të kryhen për shuarjen e detyrimit. Në fund të periudhës raportuese Llogari të pagueshme dhe të tjera të pagueshme maten me koston e amortizuar.

Huate bankare dhe të tjera

Huamarrjet maten me vlerën e drejtë të rregulluar për kostot e transaksionit (aty ku është e aplikueshme). Pas njohjes fillestare, këto maten me koston e amortizuar duke përdorur metodën e interesit efektiv.

3 Politikat kryesore kontabël (vazhdim)

3.1 Instrumentat financiarë (vazhdim)

Të tjera

Të tjera instrumenta financiare jo-derivative maten me kosto të amortizueshme duke përdorur metodën e interesit efektiv, minus çdo humbje nga zhvlerësimi.

Kontabilizimi i të ardhurave dhe shpenzimeve financiare sqarohet në piken 2.8.

Aktivet financiare klasifikohen si detyrime afatshkurtra përveç rasteve kur kompania ka të drejtë të pakushtezuar të ndryshojë marrëveshjen e huasë për të paktën 12 muaj pas datës së bilancit.

3.2 Zhvlerësimi i aktiveve financiare

Një aktiv financiar zhvlerësohet nëse ekzistojnë tregues sipas të cilëve një ose disa ngjarje kanë pasur një ndikim negativ në vlerësimin e flukseve të ardhshme të parasë prej atij aktivi.

Humbja nga zhvlerësimi në rastin e një aktivi financiar të vlerësuar me kosto të amortizuara llogaritet si diferencë midis vlerës kontabel neto dhe vlerës aktuale të flukseve të pritshme të parasë të skontuara me normën efektive të interesit.

Aktive financiare individualisht të rëndësishme testohen për zhvlerësim individualisht. Pjesa tjetër e aktiveve vlerësohen së bashku, në grupe që kanë karakteristika të ngjashme të rrezikut. Të gjitha humbjet nga zhvlerësimi njihen në fitim ose humbje.

Humbja nga zhvlerësimi mund të anulohet nëse ajo mund të lidhet objektivisht me një ngjarje të ndodhur pas njohjes së zhvlerësimit. Për aktivet financiare të vlerësuara në kosto të amortizuara anulimi i zhvlerësimit njihet në fitim humbje.

3.3 Inventaret

Inventarët maten fillimisht me kosto. Pas njohjes fillestare të tyre Shoqëria vlerëson inventarin me vlerën më të ulët midis koston dhe vlerës neto të realizueshme. Vlera neto e realizueshme i referohet vlerës neto që njësi ekonomike raportuese pret të përfitojë nga shitja e inventarit, në rrjedhën normale të biznesit.

Kostot e shkaktuara në sjelljen e secilit produkt në vendndodhjen dhe gjendjen e tanishme llogariten si më poshtë: kosto direkte që lidhet me inventarët dhe ato shpenzimet e përgjithshme që kanë ndodhur në sjelljen e inventarëve në vendndodhjen dhe kushtet aktuale të tyre. Kosto e inventarit përfshin: kostoja e blerjes së mallrave, kostoja e transportit, detyrimet doganore, akciza etj.

Vlera neto e realizueshme (VNR) përfaqëson çmimin e vlerësuar të shitjes për inventarët minus të gjitha kostot e vlerësuara të kompletimit dhe kostot e nevojshme për të bërë shitjen. Drejtimi i Shoqërisë gjatë vitit monitoron periodikisht çmimet e shitjes në koston e inventarit dhe nëse çmimi ulet nën koston, diferenca njihet në Pasqyrën e Performancës si Zhvlerësim i inventarëve. Kostoja e inventarëve bazohet në metodën e koston mesatare. Zbritja e duhur për ulje njihet në fitim dhe humbje kur ka evidencë objektive që VNR është më e ulët se kostoja.

3 Politikat kryesore kontabël (vazhdim)

3.4 Aktivet Afatgjata Materiale

(a) Njohja dhe matja

Zërat e aktiveve afatgjata materiale janë paraqitur me kosto minus amortizimin e akumuluar dhe humbjet e akumuluar nga rënia në vlerë.

Kosto përfshin shpenzimet që lidhen drejtpërdrejt me blerjen e aktivitetit dhe sjelljen e tij në kushtet e nevojshme për funksionim. Kosto e aktiveve të ndërtuara nga vetë Shoqëria përfshin koston e materialeve dhe të fuqisë punëtore, si dhe ndonjë kosto tjetër që lidhet drejtpërdrejt me vënien e aktivitetit në vendin dhe kushtet e nevojshme që ai të jetë i përdorshëm në mënyrën e synuar nga drejtimi. Blerja e programeve që janë të lidhur ngushtë me funksionalitetet e pajisjes përkatëse janë kapitalizuar si një pjesë e kësaj pajisje.

(b) Kosto të mëtejshme

Kostoja e zëvendësimit të një pjese të një elementi të aktiveve afatgjata materiale njihet në vlerën e mbartur të elementit nëse është e mundshme që përfitime ekonomike në të ardhmen që i atribuohen atij elementi do të rrjedhin në Shoqëri dhe kostoja e tij mund të matet me besueshmëri. Kostot e shërbimeve të mirmbajtjes të aktiveve afatgjata materiale njihen në pasqyrën e performancës në momentin kur ndodhin.

(c) Amortizimi/Zhvlerësimi

Pas njohjes fillestare, aktivet maten me kosto të amortizuar me metodën e vlerës së mbetur. Toka dhe Ndërtimet në Proces, si dhe parapagimet furnitorëve nuk amortizohen.

3.5 Aktivet Afatgjata Jo-Materiale

Zërat e aktiveve afatgjata jomateriale janë paraqitur me kosto minus amortizimin e akumuluar dhe humbjet e akumuluar nga rënia në vlerë.

Aktiviteti Afatgjata Jomateriale janë vlerësuar me koston e blerjes dhe kosto të tjera të drejtpërdrejta që lidhen me sjelljen e aktivitetit në kushtet e nevojshme për funksionimin e tij.

Pas njohjes fillestare, aktiviteti afatgjata jomateriale maten me kosto të amortizuar me metodën lineare.

3.6 Kuotat e kapitalit

Kuotat e thjeshta njihen si kapital. Njihet 1 (një) kuotë me vlerë 10,000,000 lekë.

3.7 Zhvlerësimi i aktiveve jo financiare

Për qëllime të çmuarjes së zhvlerësimit, aktiviteti grupohet në nivelet më të ulëta për të cilat gjenerohen flukse hyrëse parash të pavarura (njësi gjeneruese të parave). Si rezultat, disa aktive testohen individualisht për zhvlerësim dhe disa testohen në nivelin e njësisë gjeneruese të parave. Të gjitha aktivitetet individuale ose njësitë gjeneruese të parave testohen për zhvlerësim sa herë që ngjarjet ose ndryshimet në rrethana tregojnë që vlera kontabël neto mund të mos rikuperohet.

3 Politikat kryesore kontabël (vazhdim)

3.7 Zhvlerësimi i aktiveve jo financiare (vazhdim)

Një humbje nga zhvlerësimi njihet për shumën me të cilën vlera kontabël e aktivitetit (ose njësisë gjeneruese të parave) tejkalon vlerën e tij të rikuperueshme, e cila është më e larta e vlerës së drejtë minus kostot e nxjerrjes jashtë përdorimit dhe vlerës në përdorim. Për të përcaktuar vlerën në përdorim, drejtimi vlerëson flukset e parave të pritshme në të ardhmen nga secila njësi gjeneruese e parave dhe përcakton një normë të përshtatshme skontimi për të llogaritur vlerën aktuale të tyre. Të dhënat e përdorura për procedurat e testimi të zhvlerësimit janë të lidhura drejtpërdrejt me buxhetin e fundit të miratuar të Shoqërisë, të rregulluar sipas nevojës për të përjashtuar efektet e riorganizimeve dhe përmirësimeve të aktiveve në të ardhmen. Faktorët e skontimit përcaktohen individualisht për secilën njësi gjeneruese të parasë dhe pasqyrojnë vlerësimet aktuale të tregut për vlerën në kohë të parasë dhe faktorëve të rrezikut specifik të aktiveve.

Humbjet nga zhvlerësimi për njësitë gjeneruese të mjeteve monetare ulin së pari vlerën kontabël të çdo emri të mirë të alokuar për atë njësi gjeneruese të mjeteve monetare. Çdo humbje e mbetur nga zhvlerësimi i ngarkohet proporcionalisht aktiveve të tjera në njësinë gjeneruese të mjeteve monetare. Me përjashtim të emrit të mirë, të gjitha pasuritë më pas rivlerësohen nëse ka të dhëna se një humbje nga zhvlerësimi e njohur më parë mund të mos ekzistojë më. Një humbje nga zhvlerësimi rimerret nëse shuma e rikuperueshme e aktivitetit ose njësisë gjeneruese të parasë tejkalon vlerën kontabël të saj.

3.8 Njohja e te ardhurave

Të ardhurat janë hyrje bruto të përfitimeve ekonomike gjatë periudhës, të cilat vijnë nga veprimtaria e zakonshme e një njësie ekonomike kur këto hyrje sjellin rritje në kapitalin neto, përveç rritjeve që lidhen me kontributet nga pjesëmarrësit në kapital. Të ardhurat përfshijnë vetëm vlerën e drejtë të përfitimeve ekonomike të marra dhe ato që janë për t'u marrë nga shitja e mallrave dhe shërbimeve gjatë aktivitetit të zakonshëm të Kompanisë.

Të ardhurat përfshijnë shumat neto pa përfshire shumat e mbledhura për llogari të palëve të treta si taksat e shitjes, taksat e mallrave, produkteve dhe shërbimeve, si dhe tatimi i vlerës së shtuar, të cilat nuk janë përfitime ekonomike që hyjnë në njësinë ekonomike dhe nuk sjellin rritje të kapitalit neto.

Në lidhje me shitjen e mallrave, të ardhurat janë njohur kur ndryshimi i pronësise se bashku me riskun që vjen nga ky ndryshim, janë transferuar tek blerësi.

3.9 Shpenzimet

Shpenzimet janë njohur mbi bazën e të drejtave të konstatuara.

Shpenzimet që lidhen me të ardhurat e fituara gjatë periudhës raportuese njihen në të njëjtën periudhë kontabël si dhe të ardhurat përkatëse.

Shpenzimet e kryera gjatë një periudhe raportuese, që ndryshon nga periudha kur ato i sjellin përfitime Shoqërisë, regjistrohen si shpenzime pikërisht në periudhën kur merren përfitimet.

Shpenzimet për kërkime e zhvillime përgjithësisht janë ngarkuar në llogarinë e shpenzimeve në periudhën së cilës i përkasin.

3 Politikat kryesore kontabël (vazhdim)

3.10 Të ardhurat dhe shpenzimet finaciare

Të ardhurat finaciare përmbledhin të ardhurat nga interesi nga fondet e depozituara në banka, fitimet nga shitja aktiveve finaciare të mbajtura për shitje, si dhe fitimet nga këmbimet valutore. Të ardhurat nga interesi njihen si detyrime atëhere kur përdoret metoda e interesit efektiv.

Shpenzimet finaciare paraqesin shpenzimet për interesat nga huatë, humbjet nga këmbimet valutore, si dhe humbjet nga zhvlerësimet e aktivave finaciare. Gjithë kostot e huamarrjeve njihen në humbje/ fitime mbi bazën e përdorimit të metodës së interesit efektiv.

3.11 Tatimi mbi fitimin aktual dhe i shtyrë

Shpenzimi (e ardhura) tatimore përmban shpenzimin tatimor aktual (të ardhurën tatimore aktuale) dhe shpenzimin tatimor të shtyrë (të ardhurën tatimore të shtyrë). Shpenzimet që lidhen me tatimin mbi te ardhurat paraqitet ne pasqyren e te ardhurave dhe shpenzimeve pervec rasteve kur ai lidhet me zerat e kapitalit dhe ne kete rast paraqitet direkt ne kapital.

Shpenzimi tatimor aktual është shuma e tatimit që pritet të paguhet bazuar në të ardhurat e vitit ushtrimor, shkallën tatimore që zbatohet në ditën e raportimit si dhe çdo korigjim të detyrimeve tatimore të viteve paraardhese. Tatimi i shtyre njihet duke përdorur metodën e pasivit të bilancit, duke marrë si diferencë të përkohshme diferencat midis bazës tatimore të një aktivi ose pasivi dhe vlerës së tij kontabël neto në bilanc. Tatimi i shtyrë llogaritet duke u bazuar në shkallën tatimore, të përcaktuar nga ligjet që janë në fuqi, që pritet të jetë e zbatueshme në momentin kur diferenca e përkohshme do të zhduket.

Shoqëria njeh aktivin për tatim të shtyrë vetëm për aq sa është e mundur që fitimet e tatueshme të ardhshme jenë të disponueshme kundrejt të cilave të mund të përdoret aktivi tatimor i shtyrë. Vlera kontabël e një aktivi tatimor të shtyrë duhet të rishikohet në çdo datë të bilancit. Një njësi ekonomike do të zvogëlojë vlerën kontabël të një aktivi tatimor të shtyrë për aq sa nuk ka më mundësi që fitim i tatueshëm i mjaftueshëm të jetë i disponueshëm për të lejuar përfitimin e përdorimit të një pjese ose i të gjithë atij aktivi tatimor të shtyrë. Çdo zvogëlim i tillë do të rimerret deri në masën që bëhet i mundur disponimi i fitimit të tatueshëm të mjaftueshëm.

3.12 Përfitimet e punonjësve

Fondet e sigurimeve shoqërore dhe të shëndetit

Gjatë ecurisë normale të biznesit, Shoqëria bën pagesa në emër të saj dhe të punonjësve për kontributet shoqërore dhe shëndetësore, të cilat janë të detyrueshme bazuar në legjislacionin. Këto kosto të kryera në emër të shoqërisë, janë të paraqitura në pasqyrën e pozicionit financiar në momentin e ndodhjes.

3 Politikat kryesore kontabël (vazhdim)

3.13 Transaksionet në monedhë të huaj

Transaksionet në monedhë të huaj këmbehen në monedhën funksionale me kursin e këmbimit në datën e transaksionit. Aktivët dhe detyrimet monetare në monedhë të huaj në datën e raportimit këmbehen në monedhë funksionale me kursin e këmbimit të asaj date. Fitimi ose humbja nga kurset e këmbimit për zërat monetarë është diferenca midis kostos së amortizuar në monedhë funksionale në fillim të vitit dhe kostos së amortizuar në monedhë të huaj të këmbyerë me kursin e këmbimit në fund të vitit.

Aktivët dhe detyrimet jo-monetare të nominuara në monedhë të huaj të cilat maten me vlerë të drejtë këmbehen në monedhën funksionale me kursin e këmbimit të datës në të cilën është përcaktuar vlera e drejtë. Zërat jo-monetarë në monedhë të huaj të cilat maten me kosto historike këmbehen me kursin e këmbimit në datën e transaksionit.

Kurset e këmbimit zyrtare bankare të zbatuara sipas Bankës së Shqipërisë (Lekë kundrejt njësisë së monedhës së huaj) për monedhat kryesore më 31 dhjetor 2020 dhe 31 dhjetor 2019 ishin si më poshtë:

	31 dhjetor 2020	31 dhjetor 2019
EUR	123.70	121.77
USD	100.84	108.64

3.14 Ngjarjet pas datës së raportimit

Ngjarjet pas datës së raportimit që ofrojnë informacion shtesë për pozicionin e shoqërisë në datën e Pasqyrës së pozicionit financiar (veprimet rregulluese), janë të reflektuara në pasqyrat financiare. Ngjarjet pas datës së bilancit që nuk janë ngjarje për veprime rregulluese janë pasqyruar në shënimet shpjeguese kur janë materiale.

3.15 Gjykime të rëndësishme kontabël, çmuarjet dhe vlerësimet

Përgatitja e pasqyrave financiare në përputhje me SKK kërkon gjykime dhe vlerësime që ndikojnë në aplikimin e politikave kontabël dhe në raportimin e vlerave të aktiveve, detyrimeve, të ardhurave dhe të shpenzimeve. Ato gjithashtu kërkojnë që drejtimi i Shoqërisë të japë gjykimin e saj mbi zbatimin e politikave kontabël te saj. Fushat të cilat kërkojnë një shkallë të lartë ose komplekse të gjykimit ose ato për të cilat vlerësimet apo supozimet janë të rëndësishme për hartimin e pasqyrave financiare paraqiten në shënime.

Vlerësimet dhe gjykimet rishikohen vazhdimisht dhe janë bazuar në eksperiencën e mëparëshme dhe faktorë të tjerë, përfshirë edhe pritshmëritë për ngjarjet e ardhëshme, të cilët besohet se janë të përshtatshme dhe relevante për rrethanat aktuale. Rezultatet aktuale mund të ndryshojnë nga këto vlerësime. Rishikimet e vlerësimeve kontabël njihen në periudhën gjatë së cilës vlerësimi është rishikuar nëse rishikimi ndikon vetëm atë periudhë kontabël ose në periudhën gjatë së cilës vlerësimi është rishikuar dhe periudha të ardhëshme nëse rishikimi ndikon të dyja periudhat si aktuale dhe të ardhëshme.

Informacioni mbi elementë të rëndësishëm në vlerësimin e pasigurive dhe gjykimet mbi aplikimin e politikave kontabël që kanë efekt më të rëndësishëm në shumat e njohura në pasqyrat financiare janë të paraqitura më poshtë:

3 Politikat kryesore kontabël (vazhdim)**3.15 Gjykime të rëndësishme kontabël, çmuarjet dhe vlerësimet (vazhdim)****3.15.1 Tatimi mbi fitimin**

Shoqëria është subjekt i tatimit mbi fitimin në Shqipëri. Është i nevojshëm gjykimi për përcaktimin e shumës së tatimit mbi fitimin aktual dhe atyre të shtyra. Shoqëria njih detyrimin në rast të një kontrolli të pritur tatimor bazuar në vlerësimet se taksa shtesë do mund të lindin si detyrim. Nëse tatimi përfundimtar do jetë i ndryshëm nga shumat që ishin regjistruar fillimisht, diferencat do e ndikojë në vlerën aktuale të aktiveve tatimore të shtyra dhe pasiveve në periudhën në të cilën një përcaktim i tillë është bërë.

3.15.2 Parimi i vijimësisë

Pasqyrat financiare përgatiten në përputhje me parimin e vjueshmërisë, i cili nënkupton se Shoqëria do të vazhdojë operacionet e saj në një periudhë kohe të papërcaktuar, në të ardhmen e parashikuar.

Në 11 Mars 2020, Organizata Botërore e Shëndetit deklaroi gjendjen e COVID-19 si një pandemi në nivel global. Duke iu përgjigjur kërcënimit që COVID-19 paraqiti për shëndetin publik, në 12 Mars 2020 autoritetet qeveritare të Shqipërisë ndërmorën masa për kontrollimin e përhapjes, duke përfshirë futjen e kufizimeve në lëvizjen ndërkufitare të njerëzve, kufizimet e hyrjes për vizitorët e huaj në pritje të zhvillimeve të mëtejshme. Në veçanti, shkollat, universitetet, restorantet, kinematë, teatrot, muzetë dhe objektet sportive, shitësit me pakicë, duke përjashtuar shitësit e ushqimit, dyqanet ushqimore dhe farmacitë ishin të mbyllura. Disa biznese në Shqipëri gjithashtu udhëzuan punonjësit të qëndronin në shtëpi dhe kanë zvogëluar ose pezulluar përkohësisht operacionet e biznesit.

Ndikimet më të gjëra ekonomike të këtyre ngjarjeve përfshijnë:

- Ndërprerje në operacionet e biznesit dhe aktivitetin ekonomik në Shqipëri, me një ndikim bllokues në zinxhirët e furnizimit të brendshëm;
- Ndërprerje e konsiderueshme për bizneset në sektorë të caktuar, si brenda Shqipërisë, ashtu edhe në tregjet me varësi të lartë nga një zinxhir i furnizimit të huaj, si dhe bizneset e orientuara nga eksporti me mbështetje të lartë në tregjet e huaja. Sektorët e prekur përfshijnë tregtinë dhe transportin, udhëtimin dhe turizmin, argëtimin, prodhimin, ndërtimin, shitjen me pakicë, sigurimet, arsimin dhe sektorin financiar;
- Ulje e konsiderueshme e kërkesës për mallra dhe shërbime jo thelbësore;
- Një rritje në pasigurinë ekonomike, e reflektuar në më shumë çmime të paqëndrueshme të pronave dhe kursit të këmbimit të valutave.

Aktiviteti i Shoqërisë nuk u ndërpre gjatë pandemisë dhe situatës së kufizimit të lëvizjeve. Shoqëria pati impakt në ulje të shitjeve si pasojë e uljes së të ardhurave nga shitja e reklamave me 21.6%.

Bazuar në informacionin e disponueshëm publikisht, në datën kur këto pasqyra financiare ishin të autorizuar për dorëzim, Drejtimi konsideroi një numër skenarësh të besueshme në lidhje me zhvillimin e mundshëm të Covid-19 dhe ndikimin e tij të pritshëm në njësinë ekonomike dhe mjedisin ekonomik në të cilin Shoqëria operon, përfshirë masat që pritet të merren nga qeveria. Drejtimi konsideroi faktin që njësia ekonomike operon në sektorin e medias dhe vlerëson që situata e pafavorshme do të rikuperohet gjatë 2021 ku pritet rritje e shitjeve.

3 Politikat kryesore kontabël (vazhdim)**3.15.2 Parimi i vijimësisë (vazhdim)**

Si rrjedhojë, drejtimi parashikon që Shoqëria do të ketë burimë të mjaftueshme për të siguruar vijueshmërinë e biznesit për një periudhë të paktën 12 muaj nga data e raportimit. Drejtimi arriti në përfundimin se tërësia e rezultateve të mundshme të konsideruara për të arritur në këtë gjykim nuk krijojnë paqartësi materiale në lidhje me ngjarje ose kushte që mund të hedhin dyshime të mëdha në aftësinë e Shoqërisë për të vijuar aktivitetin.

4 Mjete monetare dhe ekuivalente me to

Mjete Monetare dhe ekuivalentët e tyre më datë 31 dhjetor 2020 dhe 2019 paraqiten si më poshtë:

	<u>31 dhjetor 2020</u>	<u>31 dhjetor 2019</u>
Arka	14,188	27,193
Banka	643,313	492,751
Totali	<u>657,501</u>	<u>519,944</u>

5 Llogari të arkëtueshme

Parapagimet dhe Shpenzime të shtyra përfaqësojnë shpenzimet që ju perkojnë periudhave të ardhshme.

Parapagimet dhe shpenzimet e shtyra më datë 31 dhjetor 2020 dhe 2019 paraqiten si më poshtë:

	<u>31 dhjetor 2020</u>	<u>31 dhjetor 2019</u>
Deri në 1 vit	41,368,379	7,485,015
Mbi 1 vit	-	-
Totali	<u>41,368,379</u>	<u>7,485,015</u>

6 Të tjera të arkëtueshme

Llogari të tjera të arkëtueshme më datë 31 dhjetor 2020 dhe 2019 paraqiten si më poshtë:

	<u>31 dhjetor 2020</u>	<u>31 dhjetor 2019</u>
Tatim Fitimi	18,588	18,588
TVSH	76,518	5,775,591
Tatim taksa për t'u kthyer	886	-
Totali	<u>95,992</u>	<u>5,794,179</u>

7 Parapagimet dhe shpenzimet e shtyra

Parapagimet dhe shpenzimet e shtyra më datë 31 dhjetor 2020 dhe 2019 paraqiten si më poshtë:

	<u>31 dhjetor 2020</u>	<u>31 dhjetor 2019</u>
Shpenzime të shtyra	54,598,304	50,434,556
Parapagime	135,990	344,065
Totali	<u>54,734,294</u>	<u>50,778,621</u>

8 Aktive afatgjata materiale

Aktivet Afatgjata Materiale më datë 31 dhjetor 2020 dhe 2019 paraqiten si më poshtë:

	<u>Ndertesa dhe Instalime</u>	<u>Makineri dhe Pajisje</u>	<u>Aktive të Tjera</u>	<u>Totali</u>
<i>Kosto</i>				
Më 1 janar 2019	-	8,769,680	946,862	9,716,542
Shtesa	12,465,798	18,723,174	21,799,411	52,988,383
Pakesime	-	-	-	-
Më 31 dhjetor 2019	<u>12,465,798</u>	<u>27,492,854</u>	<u>22,746,273</u>	<u>62,704,925</u>
Më 1 janar 2020	12,465,798	27,492,854	22,746,273	62,704,925
Shtesa	-	-	3,641,355	3,641,355
Pakesime	-	-	-	-
Më 31 dhjetor 2020	<u>12,465,798</u>	<u>27,492,854</u>	<u>26,387,628</u>	<u>66,346,280</u>
<i>Amortizimi</i>				
Më 1 janar 2019	-	2,884,953	16,084	2,901,037
Shpenzimi i vitit	800,899	4,504,283	3,402,098	8,707,280
Pakesime	-	-	-	-
Më 31 dhjetor 2019	<u>800,899</u>	<u>7,389,236</u>	<u>3,418,182</u>	<u>11,608,317</u>
Më 1 janar 2020	800,899	7,389,236	3,418,182	11,608,317
Shpenzimi i vitit	583,244	4,181,208	4,617,176	9,381,628
Pakesime	-	-	-	-
Më 31 dhjetor 2020	<u>1,384,143</u>	<u>11,570,444</u>	<u>8,035,358</u>	<u>20,989,945</u>
<i>Vlera Neto</i>				
Më 31 dhjetor 2019	<u>11,664,899</u>	<u>20,103,618</u>	<u>19,328,091</u>	<u>51,096,608</u>
Më 31 dhjetor 2020	<u>11,081,655</u>	<u>15,922,410</u>	<u>18,352,270</u>	<u>45,356,335</u>

Amortizimi i Aktiveve afatgjata materiale është llogaritur sipas normave të nenit 22 te Ligjit Nr. 8438, date 28.12.1998, "Për Tatimin mbi të ardhurat" ne vlere 9,381,628 leke, vlere e cila eshte njohur ne shpenzimet e vitit.

9 Aktive afatgjata jomateriale

Aktivet Afatgjata Jomateriale më datë 31 dhjetor 2020 dhe 2019 paraqiten si më poshtë:

	<i>Programe Kompjuterike</i>	<i>Programe Televizive</i>	<i>Totali</i>
<i>Kosto</i>			
Më 1 janar 2019	3,931,830	-	3,931,830
Shtesa	1,291,637	-	1,291,637
Pakesime	-	-	-
Më 31 dhjetor 2019	5,223,467	-	5,223,467
Më 1 janar 2020	5,223,467	-	5,223,467
Shtesa	-	11,249,800	11,249,800
Pakesime	-	-	-
Më 31 dhjetor 2020	5,223,467	11,249,800	16,473,267
<i>Amortizimi</i>			
Më 1 janar 2019	50,090	0	50,090
Shpenzimi i vitit	695,854	0	695,854
Pakesime	-	-	-
Më 31 dhjetor 2019	745,944	-	745,944
Më 1 janar 2020	745,944	-	745,944
Shpenzimi i vitit	671,628	-	671,628
Pakesime	-	-	-
Më 31 dhjetor 2020	1,417,572	-	1,417,572
<i>Vlera Neto</i>			
Më 31 dhjetor 2019	4,477,523	-	4,477,523
Më 31 dhjetor 2020	3,805,895	11,249,800	15,055,695

Amortizimi i aktiveve afatgjata jomateriale është llogaritur sipas normave të nenit 22 të Ligjit Nr. 8438, datë 28.12.1998, “Per Tatimin mbi të ardhurat” në vlerë 671,628 leke, vlerë e cila është njohur në shpenzimet e vitit.

10 Huatë bankare

Huatë afatshkurtra përfaqësojnë hua afatgjata në banka të nivelit të dytë në lekë në shumën 25,446,798 lekë me maturitet 2 vjet. Huatë bankare më datë 31 dhjetor 2020 dhe 2019 paraqiten si më poshtë:

	<i>31 dhjetor 2020</i>	<i>31 dhjetor 2019</i>
Të pagueshme deri në 1 vit	8,593,608	-
Të pagueshme mbi 1 vit	16,853,190	-
Totali	25,446,798	-

11 Llogari te Pagueshme

Llogari të pagueshme më datë 31 dhjetor 2020 dhe 2019 paraqiten si më poshtë:

	<u>31 dhjetor 2020</u>	<u>31 dhjetor 2019</u>
McCann Tirana	164,842	234,842.20
Big Picture	285,005	280,557.66
Albtours Vas Tour	1,000,818	1,402,534.43
Comfortably Numb	231,938	456,638.00
Albanian Telecommunication Union	2,809,187	1,450,241.73
Turner Broadcasting System Europe Limited	24,873,868	6,699,465.94
Bear Development D.O.O	3,463,600	3,409,560.00
Green Taxi Shpk	1,113,520	1,902,330.00
S&T Albania Shpk	990,904	1,220,090.35
Prompt Adriatic Shpk	652,097	641,922.73
Tilux Shpk	487,930	487,930.00
Digitalb Sh.a.	925,276	455,419.80
Globe Shops Shpk	-	355,303.33
RTSH - Radio Televizioni Shqiptar	811,789	313,582.10
Thomson Reuters	850,066	270,085.86
Furnitorë të tjerë	2,438,073	681,534
Totali	<u>41,098,913</u>	<u>20,262,038</u>

12 Detyrime ndaj shtetit

Detyrime ndaj shtetit perfaqeson kryesisht shumën e detyrimeve për sigurimet shoqërore dhe shëndetësore si dhe tatimin mbi të ardhurat personale, që i perkasin pagave të muajit dhjetor 2020.

Detyrime ndaj shtetit më datë 31 dhjetor 2020 dhe 2019 paraqiten si më poshtë:

	<u>31 dhjetor 2020</u>	<u>31 dhjetor 2019</u>
Tatim mbi të ardhurat	1,520,364	1,529,933
Sigurime shoqërore	2,788,027	2,745,115
Tatim në burim	15,000	18,000
Totali	<u>4,323,391</u>	<u>4,293,048</u>

13 Te tjera detyrime afatshkurtra

Të tjera detyrime afatshkurtra, perfaqesojnë pagat për t'u paguar që i perkasin muajit dhjetor 2020, të cilat janë paguar në janar 2021.

	<u>31 dhjetor 2020</u>	<u>31 dhjetor 2019</u>
Te Pagueshme ndaj Punonjesve	10,372,483	10,182,304
Totali	<u>10,372,483</u>	<u>10,182,304</u>

14 Kapitali i pronarëve

Kapitali i shoqërise paraqitet në shumën 10,000,000 lekë, kapital i regjistruar në Qendrën Kombëtare të Regjistrimit me ndarjen sipas ortakëve paraqitet si më poshtë:

Ortakët	<u>31 dhjetor 2020</u>		<u>31 dhjetor 2019</u>	
	%	Vlera e Kapitalit	%	Vlera e Kapitalit
Gener 2 sh.p.k	100%	10,000,000	100%	10,000,000
Totali	100%	10,000,000	100%	10,000,000

15 Shitjet neto

Shitjet neto të realizuara nga shoqëria për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2020 dhe 2019 paraqiten si më poshtë:

	<u>Viti i mbyllur më</u> <u>31 dhjetor 2020</u>	<u>Viti i mbyllur më</u> <u>31 dhjetor 2019</u>
Të ardhura nga aktiviteti	304,390,494	388,229,392
Të ardhura nga prodhimi i aktive afatgjata jomateriale	11,249,800	-
Totali	<u>315,640,294</u>	<u>388,229,392</u>

16 Shpenzime të tjera nga veprimtaria e shfrytëzimit

Shpenzime të tjera nga veprimtaria e shfrytëzimit për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2020 dhe 2019 paraqiten si më poshtë:

	<i>Viti i mbyllur më</i> <i>31 dhjetor 2020</i>	<i>Viti i mbyllur më</i> <i>31 dhjetor 2019</i>
Qera Zyresh dhe Pajisjesh	41,270,029	50,206,007
Shërbime në platformat e transmetimit	13,369,094	11,745,758
Mirëmbajtje dhe riparime	9,107,976	4,400,581
Shërbime Konsulence	1,340,000	8,078,850
Shërbime Përkthimi	435,686	656,515
Taksa, Tatime, Tarifa, etj.	639,078	227,881
Shpenzime postare dhe telekomunikimi	2,691,151	2,673,214
Shpenzime për shërbimet bankare	445,814	584,182
Transferime, udhëtime, dieta	2,078,732	4,724,269
Blerje të tjera	9,290,709	11,861,150
Shërbime të tjera	2,674,673	26,037,025
Gjoha dhe dëmshpërblime	33,112	6,867
Trajnime dhe hoteleri	-	1,105,637
Shpenzime Marketingu	12,912,269	12,753,813
Shpenzime transporti	356,648	2,264,397
Shpenzime për pritje dhe perfaqësime	59,212	184,673
Blerje online	271,249	323,166
Shpenzim për marrje sinjali CNN	80,457,733	67,685,335
Totali	177,433,165	205,519,320

17 Kosto e Punës

Kosto e Punës për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2020 dhe 2019 paraqiten si më poshtë:

	<i>Viti i mbyllur më</i> <i>31 dhjetor 2020</i>	<i>Viti i mbyllur më</i> <i>31 dhjetor 2019</i>
Paga	151,831,241	153,096,734
Sigurime shoqerore	19,105,572	18,818,483
Totali	170,936,813	171,915,217

18 Amortizimi dhe zhvleresimet

Amortizimi i Aktiveve afatgjata materiale dhe jomateriale është llogaritur sipas normave të nenit 22 të Ligjit Nr. 8438, datë 28.12.1998, “Për Tatimin mbi të ardhurat”.

	<i>Viti i mbyllur më 31 dhjetor 2020</i>	<i>Viti i mbyllur më 31 dhjetor 2019</i>
Amortizimi i AAM (shiko shënimin 8)	9,381,628	8,707,280
Amortizimi i AAJM (shiko shënimin 9)	671,628	695,854
Totali	10,053,256	9,403,134

19 Të ardhura dhe shpenzime nga interesi

Të ardhurat dhe shpenzimet nga interesi për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2020 dhe 2019 paraqiten si më poshtë:

	<i>Viti i mbyllur më 31 dhjetor 2020</i>	<i>Viti i mbyllur më 31 dhjetor 2019</i>
Te ardhura nga interesat	200	80
Shpenzime për interesa	(202,395)	-
Totali	(202,195)	80

20 Fitim / humbjet nga kursi i kembimit

Fitim/ humbjet nga kursi i kembimit për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2020 dhe 2019 paraqiten si më poshtë:

	<i>Viti i mbyllur më 31 Dhjetor 2020</i>	<i>Viti i mbyllur më 31 Dhjetor 2019</i>
Fitime nga kembimet valutore	3,541,794	(18,038)
Shpenzim nga kembimet valutore	(733,133)	(1,840,169)
Totali	2,808,661	(1,858,207)

21 Te ardhura dhe shpenzime të tjera financiare

Te ardhura dhe shpenzime të tjera financiare përfaqësojnë të ardhurat nga rimbursimi i Autoritetit të Mediave Audiovizive (AMA), sipas vendimit nr. 38, date 07.03.2019, “Per percaktimin e subjekteve Audiovizive Analoge Lokale/Rajonale qe perfshihen ne skemen e kompensimit financiar” sipas Ligjit Nr. 34/2017 “Per lirimin e frekuencave te Dixhital-Dividentit” Te ndryshuar.

	<i>Viti i mbyllur më</i> <i>31 Dhjetor 2020</i>	<i>Viti i mbyllur më</i> <i>31 Dhjetor 2019</i>
Të ardhura dhe shpenzime të tjera financiare	1,507,424	619,425
Totali	1,507,424	619,425

22 Shpenzimet e tatimit mbi fitimin

Shpenzimet e tatimit fitimit janë llogaritur sipas dispozitave ligjore tatimore në datën e mbylljes së bilancit. Detajet e llogaritjeve janë paraqitur në tabelën e mëposhtme:

	<i>Viti i mbyllur më</i> <i>31 dhjetor 2020</i>	<i>Viti i mbyllur më</i> <i>31 dhjetor 2019</i>
Fitimi/ Humbja Bruto	(38,669,050)	153,020
Humbje e mbartur	(21,799,515)	(17,883,506)
Shpenzime të panjohura	33,112	6,867
Baza e llogaritjes Tatimit	(60,435,453)	(17,723,619)
% e Tatimit Fitimit	15%	15%
Tatim Fitimi	-	-
Fitimi / Humbja NETO	(38,669,050)	153,020

23 Ngjarjet pas bilancit

Qeveria shqiptare në 2021 ka njoftuar masat e reja të kufizimeve të lëvizjes që do të hyjnë në fuqi duke filluar nga data 11 shkurt 2021, deri në një njoftim tjetër. Këto masa parashikojnë kufizim të lëvizjeve nga ora 20:00 deri në 6:00. Lëvizja publike është e kufizuar gjatë këtyre orëve me përjashtim të arsyeve të punës, emergjencave të kujdesit shëndetësor ose nevojave urgjente. Kufizimi i udhëtimit vazhdon të jetë i zbatueshëm.

Shoqëria ka përcaktuar që këto ngjarje janë ngjarje pas datës së bilancit të cilat nuk kërkojnë korigjime. Prandaj, pozicioni financiar dhe rezultatet e aktiviteteve më dhe për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2020 nuk janë korigjuar për të pasqyruar ndikimin e tyre. Kohezgjatja dhe ndikimi i pandemisë COVID-19, si dhe efektiviteti i përgjigjive të qeverisë dhe bankës qendrore, mbetet i paqartë në këtë kohë. Shoqëria nuk e ka ndëprerë aktivitetin e saj gjatë kohës së pandemisë për shkak të natyrës së aktivitetit dhe nuk ka ndonjë korigjim që ndikon në pasqyrat financiare.

Nuk ka pasur asnjë ngjarje tjetër pas datës së raportimit, e cila kërkon dhënie informacioni shtesë apo ndonjë rregullim në pasqyrat financiare.